

LIGJ
Nr.7519, datë 15.10.1991

PËR EMETIMIN E OBLIGACIONEVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Obligacionet janë letra me vlerë nominale të cilat emetohen nga organet shtetërore. Kanë të drejtë për të emetuar obligacione Ministria e Financave dhe organet e pushtetit lokal. Kriteret e emetimit, të shlyerjes dh të caktimit të përqindjeve që rrjedhin prej obligacionit, përcaktohen me akte të organeve që bëjnë emetiemin e obligacioneve.

Neni 2

Organet që emetojnë obligacione garantojnë pagimin e përqindjeve të interesave të tyre, sipas afateve të caktuara dhe vlerës nominale të obligacionit, si dhe shlyerjen e tyre në afat. Shtyrja e afatit, për raste të veçanta, bëhet me ligj.

Neni 3

Obligacionet emetohen për periudha kohe nga 2 deri në 7 vjet.

Neni 4

Të drejtën e blerjes së obligacioneve e gëzojnë të gjithë personat fizikë e juridikë vendas a të huaj, të cilët sipas legjislacionit shqiptar kanë zotësinë për të vepruar.

Neni 5

E drejta e pronësisë mbi obligacionet fitohet me blerjen e tij dhe nga kjo ditë pronarit të obligacionit i lind e drejta për të përfituar përqindjet që rrjedhin prej tij.

Neni 6

Pronari i obligacionit ka të drejtë t'ua shesë lirisht obligacionin personave të tretë në çdo kohë, me vlerën nominale të tij.

Neni 7

Ministria e Financave përcakton rregulla për zbatimin e këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.65, datë 29.10.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.

